



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL. Anr.62/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Skender Çoçaj - kryesues, Kymete Kicaj, dhe Arsim Hamzaj - anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Komuna Prishtinë, parashtruar kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dhe Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Komuna Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Lokale 2025, që do të mbahen me datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 26.09.2025, merr këtë :

V E N D I M

I. PRANOHET e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, ZL.Anr.62/2025 datë 25.09.2025.

II. Subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, Zgjedhjet Lokale 2025 që do të mbahen më datë 12 Tetor 2025, i shqiptohet dënimi me gjobë në lartësi prej 800,00 Euro (tetëqind Euro).

III. Subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, Zgjedhjet Lokale 2025 që do të mbahen më datë 12 Tetor 2025, i shqiptohet dënimi me gjobë në lartësi 500,00 Euro (pesëqind Euro)

IV. Detyrohen Subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Komuna Prishtinë, dhe Subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Komuna Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II- dhe III- të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

V. Urdhërohet Subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Komuna Prishtinë, që nga momenti i marrjes së këtij vendimi të largojë posterin e vendosur në hapësirën e parkingut nëntokësor tek nënkalimi në Ferizaj, i cili menaxhohet nga ndërmarrja publike N.P.L. "Ambient".

Arsyetim

Me datë 25.09.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë në të cilën theksohet se më datë 24.09.2025 aktivistët e Qendrës së Lëvizjes Vetëvendosje në Ferizaj, kanë vërejtur se kandidatët për Asamblenë Komunale nga radhët e partive Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dhe Partia Demokratike e Kosovës, Arton Gavazi, përkatësisht Maliq Muharremi, kanë vendosur postera zgjedhorë në hapësirën e parkingut nëntokësor tek nënkalimi në Ferizaj, i cili menaxhohet nga ndërmarrja publike N.P.L. "Ambient".

Ky veprim përbën shkelje të dispozitave ligjore për fushatën zgjedhore. Në këtë rast, hapësira ku janë vendosur postera —parkingu nëntokësor tek nënkalimi në Ferizaj — është pasuri publike e menaxhuar nga ndërmarrja komunale "N .P.L Ambienti". Ajo nuk është e destinuar për reklama zgjedhore dhe, për më tepër, nuk ka qenë asnjëherë më parë e shfrytëzuar si hapësirë reklamuese. Andaj, duke u mbështetur në bazën ligjore dhe argumentet e lartcekura, kërkojnë që Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa të konstatojë shkeljen e bërë nga subjektet AAK dhe PDK dhe të shqiptojë sanksionin sipas legjislacionit në fuqi. Si prove në ankesë ka bashkangjitur fotografi.

Në përgjigje në ankesë Subjekti Politik AAK, kundërshton në tërësi pretendimet e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, duke i konsideruar ato të pabazuara. Në asnjë moment, z. Arton Gavazi nuk ka bërë shkelje të dispozitës të LZP-së, ankesa e subjektit politik LVV, përmban një përshkrim të paqartë dhe të pasaktë të situatës faktike, me qëllim të konfuzionit tek shqyrtuesi i ankesës. Më tej në përgjigje sqarojnë se nuk është kontestues fakti se z. Gavazi ka vendosur posterin në nënkalimin i cili ndodhet në Rr. Ahmet Kaçiu. Kontestues për parashtfuesin e ankesës është keqinterpretim i gjendjes faktike nga LVV, që kinse kemi të bëjmë me shkelje të dispozitës përkatëse të LZP-së. Parashtruesi i ankesës, ka të lidhur me datë 09.09.2025 një "KONTRATË TË QIRASË", përmes së cilës subjekti politik AAK, e merr me qera hapësirën në rr. "Ahmet Kaçiku", Ferizaj, përkatësisht në nënkalimin e këmbësorëve dhe në parkingun e veturave në nënkalim. Sipas nenit 2, të kësaj kontrate, parashihet se: *"Hapësira do të përdoret ekskluzivisht për nevojat e fushatës zgjedhore të kandidatëve për asamble komunale të subjektit politik AAK, për një periudhë të përkohshme zgjedhore me qëllim të vendosjes së Posterave (bilbordëve) të kandidatëve të këtij subjekti politik "*

Si prove në përgjigje ka bashkangjitur Kontratën qirasë të datës 09.09.2025, dhe Vendimi me nr. të referencës 376, nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit;

Në përgjigje në ankesë të subjektit politik PDK thekson se e njëjta ka shpërndarë udhëzimet përkatëse dhe ka njoftuar të gjithë kandidatët e saj për asamble komunale, në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës, lidhur me detyrimin për respektimin e rregullave zgjedhore të përcaktuara në Ligiin për Zgjedhjet Lokale, Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe në Kodin e Mirësjelljes.

Më tej në përgjigje theksohet se kandidati për Asamblenë Komunale, z. Maliq Muharremi, ka lidhur kontratë të rregullt me kompaninë "MB PARAMOUNT" Sh.P.K., e regjistruar me numër reference 812274174, kjo kontratë përcakton obligimet e ndërsjella të palëve, duke përfshirë shërbimet e ofruara nga kompania dhe të drejtat e kandidatit në raport me shfrytëzimin e hapësirave të dedikuara për qëllime të fushatës zgjedhore,

Gjithashtu, në përputhje me legjislacionin në fuqi, kompania "MB PARAMOUNT" Sh.P.K. ka siguruar vendimin përkatës nga Drejtoria e Urbanizmit në Komunën e Ferizajt, nr. 376, për vendosjen e posterëve dhe materialeve të tjera zgjedhore në hapësirat publike të përcaktuara. Ky vendim konfirmon se veprimtaria e ushtruar është në pajtim me rregulloret komunale dhe me dispozitat ligjore përkatëse që rregullojnë përdorimin e hapësirave publike gjatë fushatës zgjedhore.

Megjithatë, menjëherë pas pranimit të kësaj ankese, kandidati i tyre ka ndërmarrë veprim të menjëhershëm dhe ka larguar posterin e tij nga vendi i kontestuar, duke demonstruar vullnetin e plotë për respektimin e rregullave zgjedhore dhe për mbajtjen e një gare të drejtë dhe të barabartë.

Si provë në përgjigje kanë bashkangjitur kontratën e nënshkruar ndërmjet kandidatit dhe kompanisë në fjalë dhe fotografi nga vendi ku është larguar posteri.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa-PZAP, pasi shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, gjeti se:

-Ankesa është e bazuar.

Paneli pasi që shqyrtoi pretendimet ankimore, ka gjetur se nga provat materiale e bashkangjitur ankesës, të Subjektit Politik LVV, dhe shkresave tjera të lëndës, paneli ka vlerësuar se kandidatët për Asambleenë Komunale nga radhët e partive Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dhe Partia Demokratike e Kosovës, Arton Gavazi, përkatësisht Maliq Muharremi, kanë vendosur postera zgjedhorë në hapësirën e parkingut nëntokësor tek nënkalimi në Ferizaj, i cili menaxhohet nga ndërmarrja publike N.P.L. "Ambient", duke shfrytëzuar hapësirën publike për promovimin e kandidaturës së tyre.

Bazuar në këtë të njëjtit kanë shkelur Rregulla Zgjedhore Nr.07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, pasi që janë shfrytëzuar hapësirat publike për qëllime elektorale, veprime këto të cilat bien në kundërshtim me dispozitën e nenit 36 paragrafi 1 nën paragrafi 2 Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në të cilin nen në mënyrë decitive thuhet se 1.2." *vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve;*

Në përgjigje në ankesë të Subjektit Politik AAK, referuar nga ky subjekt, pretendohet se për vendosjen e materialeve reklamuese-postereve posedojnë Kontratë me Operatorin Ekonomik kompania "MB PARAMOUNT" Sh.P.K., datë 09.09 2025, sipas së cilës si në pikën 2 të kësaj kontrate, iu është dhënë e drejta subjektit politik AAK të vendosë posterat-billbordet në këtë hapësirë publike.

Paneli gjatë shqyrtimit të provave gjegjësisht Vendimi me nr. të referencës 376, nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit e Komunës së Ferizajt, të datës 14.05.2025, ka vërejtur se me këtë vendim i është dhënë pëlqimi personit Bekim Çalaj për vendosjen e Led ekranit në nënkalimin e këmbësorëve, po ashtu me këtë vendim Bekim Çalaj është obliguar që të lidhë kontratë të qirasë me Drejtorinë për Financa të Komunës së Ferizajt. Në këto rrethana

Paneli konstatoi se nuk është ofruar ndonjë dëshmi që tregon se Bekim Çalaj ka lidhë kontratë të qirasë me Drejtorinë për Financa të Komunës së Ferizajt po ashtu nuk ka dëshmi që tregojnë se i njëjti ka të drejtë që të njëjtat hapësira reklamuese ti jap me qira personave të tretë, në këtë rast subjektit politik AAK dhe subjektit politik PDK.

Sipas vlerësimit të panelit konstatohet se kandidati për anëtar të Kuvendit Komunal të Komunës së Ferizajt, nga radhët e subjektit politik AAK, dhe kandidati për anëtar të Kuvendit Komunal të Komunës së Ferizajt, nga radhët e subjektit politik PDK kanë shfrytëzuar hapësirat e publike gjatë fushatës zgjedhore me qëllim të përfitimit të votave. Rrjedhimisht sipas vlerësimit të panelit veprimet e këtyre kandidatëve për anëtar të Kuvendit Komunal të Ferizajt bien ndesh me dispozitën e nenit 36 paragrafi 1.2 të Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe Rregullës zgjedhore nr.07/2024.

Paneli, me rastin e vendosjes së gjobave si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim : natyrën e shkeljes, dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes. Kjo konsiston në atë se subjektet politike AAK dhe PDK kanë qenë të njoftuara me obligimet dhe përgjegjësitë gjatë procesit të fushatës zgjedhore. Paneli me rastin e shqiptimit të gjobës ndaj subjektit politik PDK, si rrethanë lehtësuese ka marr faktin se është larguar posteri nga vendi i kontestuar, që tregon se është bërë përpjekje serioze për evitimin e shkeljes së bërë, si dhe praktikën e PZAP-it, për rastet të ngjashme, të vendosura në PZAP.

Paneli vlerëson se në rastin konkret kandidati Arton Gavazi, nga AAK, urdhërohet që nga momenti i marrjes së këtij vendimi të largojë posterin, ndërsa dështimi për t'iu bindur kësaj urdhëresë të PZAP-it, brenda periudhës së përmendur në vendim, paraqet shkelje tjetër të këtij ligji që mund të sanksionohet me dënime shtesë nga PZAP-i.

Nga arsyet e theksuara me lartë, e në kuptim të nenit 33 par. 5, nenit 36 paragrafi 1.2 neni 118 paragrafi 1, neni 120 paragraf 1 nën paragrafi 1.3, të Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.62/2025 më datën 26.09.2025

**Kryesues i Panelit,
Skender Çoçaj**



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.